

KËRKIME GJUHËSORE

Asime FERAJ

RRETH SINTAGMATIKËS DHE LIDHJEVE SINTAGMATIKE NË FJALORËT SHPJEGUES

Hyrje: Punimi ka trajtuar sintagmatikën në fjalorët shpjegues kombëtarë, të printuar (jo elektronikë), gjuhësorë, njëgjuhësh dhe alfabetik pasi sintagmatika në një fjalor mund të kalohet si pa u vënë re, sepse, konsiderohet si më pak e rëndësishme se shpjegimet a përkufizimet ose se barasvlerësit (kur fjalori është dygjuhësh), çka mund të jetë e vërtetë. Por, nëse, p. sh., nuk thuhet dot në shpjegim se një folje a mbiemër mund të lidhet me fjalë që shënojnë objekte të gjalla ose të pagjalla, atëherë përdoruesi mund të shohë shembujt ilustrues (*u ftoh moti / u ftoh nga shokët; dhomë e ftohtë / njeri i ftohtë; ecën njeriu (kali) / ecën koha (ecën puna)*).

Prof. Hajri Shehu, duke krijuar edhe një term të ri për sintagmatikën në një fjalor, termin *shembullsimi*, thekson se “Shembullsimi në fjalor, ilustrimi i glosës me shembull, fjala bashkë me fjalën është njëra nga tri teknikat leksikografike (të tjerat janë: shpjegimi, në kuptimin e gjerë të fjalës në leksikografi, dhe barasvlerësimi në fjalorë dygjuhësh), sepse fjalorët kanë nevojë për ekologjinë e fjalëve, domethënë, për ndër lidhjet kontekstuale, për bashkëlidhjet e zakonshme të fjalëve”.

Shembujt ilustrues ndihmojnë për zbulimin më të plotë të kuptimit dhe shërbejnë si mjet plotësues për karakterizimin e fjalës, duke treguar sferën e përdorimit, rrethimin tipik leksiko-gramatikor, vërtetojnë vlerësimin stilistikor dhe karakteristikën gramatikore që i jepet fjalës.

Objekti dhe qëllimi i studimit

Sot, kur bota shqiptare zhvillohet në mënyrë shumë të shpejtë e të gjithanshme, përdorimi dhe shfrytëzimi i fjalorëve shpjegues apo joshpjegues, njëgjuhësh a dy e shumëgjuhësh, gjuhësorë apo enciklopedikë, është dukuria më e zakonshme dhe më e pashmangshme, sepse këto vepra jo vetëm janë regjistruar të fjalës e të frazeologjisë, të pasurisë leksikore e semantike, kombëtare a ndërkombëtare, por kanë peshën e tyre përcaktuese në zotërimin e gjuhës shqipe dhe në zgjerimin e kompetencës gjuhësore e komunikatave, në gjetjen e një fjale të panjohur, në gjetjen e shpjegimit të saj kuptimor, apo në gjetjen e njësave leksikore a semantike me të cilat ajo hyn në lidhje semantike, paradigmatiske, fjalëformuese, stilistikore etj.

Qëllimi i kryesor i punimit tonë është që, duke u mbështetur në lëndën që ofrojnë vepra të tilla të pazëvendësueshme, të trajtojmë rëndësinë e sintagmatikës te fjalorët shpjegues, si një anë e domosdoshme për të njohur fjalën dhe kuptimin e saj, për të rritur kompetencën leksikore dhe semantike të përdoruesve të këtyre fjalorëve.

Sintagmatika dhe lidhjet sintagmatike në fjalorët shpjegues

Sintagmatika në një fjalor përfshihet tek ilustrimet, të cilat janë dy llojesh: *grafike*, si fotografi, harta e skica (kryesisht në fjalorët enciklopedikë,

ideografikë etj.) dhe *gjuhësore*, si *thënie* Rreth sintagmatikës dhe lidhjeve sintagmatike në fjalorët shpjegues (*togje fjalësh*) dhe *shembuj të plotë (fjali)*. Në fjalorët shpjegues përdoren zakonisht ilustrimet e llojit të dytë. *Thëniet* janë togje të shkurtra fjalësh, që vihen pas shpjegimit të një kuptimi, për ta plotësuar atë me elemente e nuanca më të imëta të atij kuptimi, të cilat nuk mund të jepen të gjitha në shpjegim. Thëniet tregojnë që kjo fjalë në këtë kuptim është reale në gjuhë dhe ka këtë fushë e këto veçori përdorimi. Kurse *shembujt* shërbejnë për të plotësuar shpjegimin e kuptimit me nuanca të holla semantike, emocionuese, shprehëse, stilistike, të përdorimit etj.

Prof. Hajri Shehu, duke parë rolin e sintagmatikës në një fjalor thekson se “jashtë kontekstit, *jashtë përkatësisë sendore - nocionore konkrete* fjala sjell informacion të papërcaktuar dhe ka vetëm kuptim potencial. Ajo e merr plotësisht kuptimin e saj real, si të thuash semantizohet në një kontekst a situatë të caktuar, ku asnjansohen disa përbërës të saj kuptimorë e aktualizohen disa të tjerë. Në këtë aspekt, kuptimi është rezultat i bashkëlidhjes së fjalës me mjedisin rrethues [në qoftë se *u çmend / u tërbua / u marros / u ndërkrue / shkalloi* nuk do të vihej *pas saj / pas tij*, nuk do të kishim kuptimin “e do jashtë mase dikë a diçka”, por kuptimin konkret “humbi aftësinë për të menduar, u sëmur nga mendja]. Në mënyrë të veçantë, kuptimet e foljes shumëkuptimëshe varen nga mjedisi rrethues, nga emrat me të cilët bashkëlidhen; krahaso: shtroj *drekën/ shtroi një drekë/ shtroi të shoqen në spital/ e shtroi për diskutim/ shtroj makinën / shtroi dy pula* “vuri kllloçka dy pula” / shtroi *speca (domate)* “vuri turshi speca (domate)” etj.

Kjo lidhje tregon pa dykuptimësi se cila është përmbajtja e fjalës ose, siç thotë L. Vitgenshtein, “ajo që nuk mund të shprehet në shenjë, shfaqet në përdorimin e saj”. E, leksikografi është i detyruar ta japë përmbajtjen e fjalës pa dykuptimësi, ta pasqyrojë atë që quhet aktualizim i njëjësive leksikore.”¹

Prof. Hajri Shehu shprehet se në një fjalor shpjegues thëniet kanë funksione të ndryshme, duke renditur të paktën 16 prej tyre. Këto funksione të thënieve dhe ilustrimet e shumta me to i gjejmë në të gjithë fjalorët e shqipes, pavarësisht nga tipi apo lloji i tij. Por Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, është fjalori me një numër shumë të madh thëniesh, numri i të cilave vjen duke u ulur në Fjalorin e shqipes së sotme dhe akoma më tej në Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006 *thëniet kanë vlerë denotative (elektrodë pozitive* është “anodë”, *elektrodë negative* është “katodë”, *puçërr e zezë* është “plasja”; *kanë vlerë konotative* (shih p. sh. kuptimet e kushtëzuara sintaksore, që lindin veçse në një kontekst të caktuar: tipi është *dhëlpër ai* etj.); *thëniet diferencojnë kuptimet e fjalëve shumëkuptimëshe* (*zë i frikshëm* “të shtie frikën” / *njeri i frikshëm* është “njeri frikacak”); *saktësojnë kuptimet e kryehershme* (kallëzuan *grunjërat* “nxorën kallëzit”); *saktësojnë ngjyrimet kuptimore të sinonimeve* (krahaso ndajfoljet *shumë e tepër*); *plotësojnë informacionin që jepet në shpjegimin e glosës* (*zvarranikët pjellin vezë*); *motivojnë regjistrat shkencorë të njëjësive leksikore a të kuptimeve të tyre* (krahaso *pika e*

¹ Shih më gjerë H. Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë shpjegues të shqipes*, në “leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 161.

RRETH SINTAGMATIKËS DHE LIDHJEVE SINTAGMATIKE NË FJALORËT SHPJEGUES

vlimit dhe vëmë pikë në fund të fjalisë); *ilustrojnë njësitë e çerdhes fjalëformuese* (krahaso *natë* e pagjumë dhe *vuan* nga pagjumësia;); *tek emrat prejfoljorë, thëniet shërbejnë për të dalluar veprimin, gjendjen, rezultatin (gjetje te gjetja e xeherorit është veprim; tek është një gjetje e bukur “zgjedhje e mirë” e te gjetje të reja arkeologjike “sendet që zbulohen gjatë gërmimeve” gjetje shënon rezultat); motivojnë vlerat stilistike të fjalëve a të kuptimeve të tyre* (krahaso *e hëngri bukën* dhe *e hëngri të shkretën vajzë*); dhe *tregojnë nivelin stilistik të përdorimit* (dhe fjalori e ka për detyrë të japë informacion stilistik); *veçojnë homonimet* (erë_I e *butë* është “juga” / erë_{II} e *mirë* është “ajo që ndihet me hundë”); *dallojnë paronimet* (krahaso *kryetari i bashkisë* dhe *kryetari i bashkësisë*); *veçojnë njësitë paronomazike* (krahaso *muzikë shekullare* dhe *muzikë shekullore*); *mbështesin dhe plotësojnë barasvlerësit në një fjalor dygjuhësh* (krahaso, p. sh. *sapun i butë* “soft soap” dhe *klimë e butë* “mild climate”) etj.

Fjala ka aftësi që të lidhet me fjalë të tjera në njësi më të larta, si togfjalëshi, fjalia e periudha, d.m.th. ka *vlera sintagmatike*. Çdo fjalë që të marrim, në çdo kuptim të saj, *formon disa lidhje leksematike (leksiko-sintaksore) me fjalë të tjera, ku shpërfaq edhe vlerat e përmbajtjes, ngjyresat emocionuese a stilistike, deri edhe kuptimet frazeologjikisht të lidhura*. Kështu, *dor/ë-a f.* hyn në lidhje të shumta me fjalë të tjera, si: *dora e djathtë (e majtë)*, *i dha dorën, prek me dorë, ka dorë, ia la në dorë ... i mirë* mund të ketë bashkëlidhje të pakufi, por në ligjërim, në kuptimin “i djathtë” lidhet pothuajse vetëm me *dorë / këmbë / sy*).

Fjalët më të lashta dhe ato me shumë kuptime kanë leksematikë të gjerë dhe mundësi për lidhje të reja fjalësh. Nëpërmjet këtyre lidhjeve kryhet marrëveshja gjuhësore, sepse kjo bashkëlidhje leksikore është *lidhje sendore-logjike që ekzistojnë në veprimtarinë reale ndërmjet sendeve dhe dukurive që shënohen nga fjalët* (shih p. sh. togfjalëshat që kanë të bëjnë me grupin tematik të njerëzve sipas dukjes a tipareve morale: thuhet *i ka sytë të larmë*, por jo *i ka vetullat të larme*; thuhet *ka gojë të ëmbël*, por nuk thuhet *ka dhëmbë të ëmbël*). Kjo rregullsi mund të quhej *ligji i valencës*².

Sipas J. Thomait “*Shembujt* gjithashtu shërbejnë për të plotësuar shpjegimin e kuptimit me nuanca të holla semantike, emocionuese, shprehëse, stilistike, të përdorimit etj., por, më shumë se thëniet, ato japin edhe bukurinë e shprehjeve me këtë fjalë, jetën e saj të gjallë në ligjërim të ndryshme. Shembujt shoqërohen me burimin e tyre (autori, vepra, gazeta etj.) për të krijuar ndjenjën e sigurisë së përdorimit të fjalës në kontekstin e dhënë.

Sintagmat a thëniet në fjalor ilustrojnë sjelljen gramatikore (fonologjike, morfologjike, sintaksore) të fjalës (p. sh., tipin e objektit: *shkroi letër* dhe *i shkroi të vëllait*, llojin e mbiemrit: *tryezë e gjerë / tryezë katrore* etj.).

Sipas prof. Androkli Kostallarit, **materiali ilustrues** në artikujt për çdo fjalë do të përbëhet kryesisht nga **këto citate** (shembuj): *citata, konteksti i të cilave*

² Për teorinë e valencave shih: A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në “Studime filologjike”, 1968, 4, f. 44-46.

ASIME FERAJ

ndihmon për thellimin e njohjes së këtij ose të atij kuptimi të fjalës ose të një nuance të caktuar kuptimore; citate, të cilat vërtetojnë shënimin stilistikor që i është vënë fjalës.

PËRFUNDIME

Së pari kam synuar që sintagmatika që lidhet me shembujt, me thëniet etj., edhe pse ka të bëjë me lëndën ilustruese, të rivlerësohet si pasuri me vlera dhe me peshë jo të vogël në një vepër leksikografike.

Meqenëse fjalorët janë vepra të pazëvendësueshme në shkollë, në punën time si mësuese e gjuhës dhe e letërsisë, por edhe rolin nxënës të fëmijëve në shkollë se shembujt ndihmojnë për të krijuar ndjenjën e sigurisë në përdorimin e fjalës në kontekste të ndryshme.

Shembujt janë fjali të zgjedhura mirë, nga shkrime të mjeshtërive të gjuhës, të rregullta jo vetëm nga ana e ndërtimit gjuhësor, por edhe nga përmbajtja e nga “estetika” e shprehjes, nëpërmjet të cilave lexuesi fiton vlera të reja për fjalën dhe ndien bukurinë e forcën e gjuhës.

BIBLIOGRAFI

- A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972.
Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.
Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984 / 2002.
Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2004.
Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954.
Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.
- H. Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*, në *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005.
- V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999.
- V. Memisha, *Rreth vargut fjalëformues folje - emër veprimi – mbiemër prejpjesor në fjalorët shpjegues të shqipes*, në *Leksikologjia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005.